<p>3. Kryesuesi, Kryetari i Komisionit për Çështje Normative dhe Kryetari për Çështjen e Vlerësimit të Performancës shërbejnë në Këshill me kohë të plotë dhe pezullojnë detyrën e gjyqtarit.</p> <p>4. Anëtarët nga paragrafi 3 i këtij neni nuk do të humbasin statusin e tyre si gjyqtar, dhe kanë të drejtë t'i kthehen shërbimit si gjyqtarë në gjykatën në të cilën kanë shërbyer para emërimit në pozitën e anëtarit të Këshillit.</p> <p>5. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të anëtarit të Këshillit, i njëjti nuk mund të ngritet në detyrë, si dhe nuk mund të emërohet Kryetar i Gjykatës përkatëse.</p> <p>6. Kryesuesi, zëvendës kryesuesi dhe anëtari i Këshillit që para fitimit të mandatit ka qenë i punësuar në sektorin publik ose në institucionin që financohet me mjete publike, ka të drejtë vazhdimin e funksionit në pozitën e tij të njëjtë ose në pozitë të rangut të njëjtë pas përfundimit të mandatit të anëtarit në Këshill. Për këtë qëllim Këshilli duhet t'ia parashtrijë kërkesën e tij punëdhënësit brenda afatit më së largu prej tre (3) muajve pas përfundimit të mandatit.</p> <p>7. Afati i qëndrimit në detyrë i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit fillon nga data e zgjedhjes së tyre.</p>	<p>3. The Chair, the Chair of the Committee for Normative Issues, and the President of the Committee for Evaluation of the Performance shall serve to the Council on a full-time basis, thus suspending the duty of the judge.</p> <p>4. The Council members from paragraph 3 of this Article shall not lose their status as a judge, and have the right to return to their duty as judges in the courts where they have served before they were appointed Council members.</p> <p>5. The Council member cannot be promoted or appointed as President of the relevant Court during the exercise of his/her function as a member of the Council.</p> <p>6. The Chair, the Vice-Chair and the Council member who, prior to obtaining the mandate, had been employed in the public sector or in an institution funded by public funds, has the right to continue the function in his or her position of another position of the same rank after the end of the mandate of the Council member. For this purpose, the Council must submit its application to the employer not later than three (3) months after the end of the mandate.</p> <p>7. The term of office of the elected members of the Council commences from the date of their election.</p>	<p>3. Predsedavajući, Predsednik komisije za normativna pitanja, i Predsednik komisije za vrednovanje učinka angažovani su u sklopu Saveta na puno radno vreme, i time obustavljaju funkciju sudije.</p> <p>4. Članovi iz stava 3 ovog člana neće izgubiti status sudije i imaju pravo da se vrate na poziciju sudije unutar suda unutar kojeg su radili pre imenovanja na poziciju člana Saveta.</p> <p>5. Član Saveta ne može biti unapređen, postavljen za predsednika suda tokom trajanja mandata u svojstvu člana Saveta.</p> <p>6. Predsedavajući, zamenik predsedavajućeg i član Saveta koji je, pre početka mandata bio zaposlen u javnom sektoru ili instituciji finansiranoj iz javnih sredstava, ima pravo da nastavi obavljati svoju funkciju ili poziciju istog ranga nakon prestanka mandata. U tom cilju, Savet mora da podnese zahtev poslodavcu najkasnije u roku od tri (3) meseca nakon završetka mandata.</p> <p>7. Mandat izabranih članova Saveta počinje od dana njihovog izbora.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 13 Përfundimi i mandatit</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Termination of the term</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Završetak mandata</p>
<p>1. Mandati i anëtarit të Këshillit përfundon me:</p> <p>1.1. vdekje;</p> <p>1.2. humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkaqe mjekësore të vërtetuara;</p> <p>1.3. dështimin e vazhduar për të marrë pjesë në veprimtaritë e Këshillit për më gjatë se tre (3) muaj;</p> <p>1.4. pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi;</p> <p>1.5. skadimin e mandatit;</p> <p>1.6. dorëheqje, duke i ofruar Këshillit njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh;</p> <p>1.7. arritjen e moshës së pensionimit;</p> <p>1.8. është dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë;</p> <p>2. Anëtarët e Këshillit shkarkohen nga funksioni para skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur, nëse:</p>	<p>1. The mandate of a member of the Council ends upon:</p> <p>1.1. his/her death;</p> <p>1.2. loss of capacity to act for more than three (3) months due to certified medical reasons;</p> <p>1.3. repeated failure to attend the activities of the Council for more than three (3) months;</p> <p>1.4. termination of the status on which the appointment is based;</p> <p>1.5. expiration of the mandate;</p> <p>1.6. resignation, by submitting to the Council a notice of thirty (30) days in advance;</p> <p>1.7. reaching the retirement age;</p> <p>1.8. conviction for a criminal offense by a final decision;</p> <p>2. Members of the Council shall be dismissed from office before the expiry of the mandate they have been elected for, if:</p>	<p>1. Mandat člana Saveta završava se u slučaju:</p> <p>1.1. smrti;</p> <p>1.2. gubitka sposobnosti delovanja duže od tri (3) meseca zbog potvrđenih medicinskih razloga;</p> <p>1.3. uzastopnog neuspeha učesća u aktivnostima Saveta više od tri (3) meseca;</p> <p>1.4. prekida statusa na kojem se zasniva imenovanje;</p> <p>1.5. isteka mandata;</p> <p>1.6. ostavke, uz prethodno obaveštenje koje se Savetu treba dostaviti trideset (30) dana unapred;</p> <p>1.7. dostizanja starosne granice za penzionisanje;</p> <p>1.8. osude za krivično delo pravosnažnom presudom;</p> <p>2. Članovi Saveta se razrešavaju sa dužnosti pre isteka mandata na koji su izabrani, ukoliko:</p>

<p>2.1. funksionin e anëtarit të Këshillit nuk e kryen në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;</p> <p>2.2 ushtron funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.</p> <p>3. Nëse një vend në Këshill lirohet para skadimit të mandatit të një anëtari, pozita e lirë plotësohet në të njëjtën mënyrë si për anëtarin të cilit i ka skaduar mandati. Personi, i cili zgjedhet të plotësojë një vend të lirë në Këshill emërohet apo zgjedhet me një mandat të plotë pesë (5) vjeçar.</p> <p>4. Procedura për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga anëtarët e gjyqësorit, fillon tre (3) muaj para skadimit të mandatit të rregullt.</p>	<p>2.1. he/she fails to perform the function of the Council member in accordance with the Constitution and the law, and</p> <p>2.2. he/she exercises the function contrary to the duties and responsibilities.</p> <p>3. If a seat in the Council is vacated before the expiration of a member's mandate, the vacancy shall be filled in the same way as for the member whose mandate has expired. A person who is selected to fill a vacancy in the Council is appointed or elected for a full term of five (5) years.</p> <p>4. The procedure for election of members of the Council by members of the judiciary begins three (3) months before the expiration of the regular mandate.</p>	<p>2.1. se funkcija člana Saveta ne vrši se u skladu sa Ustavom i zakonom;</p> <p>2.2.vrši svoju funkciju suprotno njegovim dužnostima i odgovornostima.</p> <p>3. Ako se članstvo u Savetu oslobodi pre isteka mandata člana, upražnjeno mesto će se popuniti način predviđen za člana čiji je mandat istekao. Lice odabrano da popuni upražnjeno mesto u Savetu imenuje se ili bira na puni mandat od pet (5) godina.</p> <p>4. Postupak izbora članova Saveta od strane članova pravosuđa počinje tri (3) meseca prije isteka redovnog mandata.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Natyra publike e takimeve të Këshillit</p> <p>1. Takimet e Këshillit janë të hapura për publikun.</p> <p>2. Rendi i ditës së Këshillit do të jetë publikisht i hapur së paku njëzet e katër (24) orë para takimit.</p> <p>3. Këshilli mund të vendos të mbajë takim të mbyllur për publikun me shumicën e votave të anëtarëve për çështjet si në vijim:</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 The public nature of Council meetings</p> <p>1. Council meetings are open to the public.</p> <p>2. The agenda of the Council will be become public at least twenty-four (24) hours before the meeting.</p> <p>3. The Council may decide to hold a closed meeting with the majority of members' votes on the following matters:</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Javna priroda sastanaka Saveta</p> <p>1. Sastanci Saveta su otvoreni za javnost.</p> <p>2. Dnevni red Saveta će biti javno otvoren najmanje 24 časa pre sastanka.</p> <p>3. Savet, većinom glasova članova može odlučiti da održi zatvoreni sastanak kada je u pitanju sledeće:</p>

<p>3.1. një sekret shtetëror zyrtar zbulimi i të cilit do të ishte shkelje e ligjit;</p> <p>3.2. çështje e personelit që kanë të bëjnë me gjyqtarë apo punonjës të gjyqësorit, përpos takimit të Këshillit ku merret një vendim përfundimtar disiplinor kundër një gjyqtari;</p> <p>3.3. informacioni jo publik apo zbulimi i të dhënave që do të rrezikonin jetën apo sigurinë e cilitdo person;</p> <p>3.4. një hetim në vazhdim për sjellje të pahijshme apo veprimtari kriminale zbulimi i së cilës në masë të arsyeshme do të rrezikonte objektivitetin dhe efikasitetin e hetimit;</p> <p>3.5. vlerësimi i performansës së gjyqtarëve dhe nëpunësve administrative;</p> <p>3.6. informacioni pronësor zbulimi i së cilës mund të paragjykonte interesat e cilësdo palë që konkurren për një tender qeveritar;</p> <p>3.7. informacione, të dhëna, procese apo kode kompjuterike të biznesit pronësor të cilat janë konfidenciale sipas marrëveshjes kontraktuese apo marrëveshjes për mos zbulim ndërmjet tregtarit dhe Këshillit; dhe</p>	<p>3.1. an official state secret whose disclosure would be a violation of the law;</p> <p>3.2. staff issues concerning judges or judiciary employees, except the Council meeting where a final disciplinary decision is taken against a judge;</p> <p>3.3. non-public information or data disclosure that would endanger the life or safety of any person;</p> <p>3.4. an ongoing investigation on misconduct or criminal activity whose disclosure would reasonably prejudice the objectivity and efficiency of the investigation;</p> <p>3.5. performance assessments of judges and administrative officers;</p> <p>3.6. asset information whose disclosure could prejudice the interests of any party competing for a governmental tender;</p> <p>3.7. business asset information, data, processes or computer codes that are confidential under a contractual agreement or a non-disclosure agreement between the trader and the Council; and</p>	<p>3.1. državna zvanična tajna čije bi objavljivanje predstavljalo kršenje zakona;</p> <p>3.2. pitanja osoblja koja se tiču sudija ili ostalih uposlenih unutar pravosuđa, osim u slučaju sednice Saveta kada treba biti doneta konačna odluka disciplinskog postupka;</p> <p>3.3. informisanja javnosti ili otkrivanja podataka koji bi ugrozili život ili bezbednost bilo koje osobe;</p> <p>3.4. istrage o nepravilnom ponašanju ili kriminalnim aktivnostima čije bi obelodanjivanje razumno ugrozilo objektivnost i efikasnost istrage;</p> <p>3.5. vrednovanja učinka sudija i administrativnih službenika;</p> <p>3.6. vlasničke informacije čije objavljivanje može ugroziti interese bilo koje stranke koja se takmiči za vladin tender;</p> <p>3.7. vlasničke poslovne informacije, podataka, postupaka ili računarskih kodova koji su poverljivi po ugovornom sporazumu ili sporazumu o neotkrivanju između trgovca i Saveta; i</p>
--	---	--

<p>3.8. cilido informacion tjetër zbulimi i të cilit do të përbënte shkelje të ligjit.</p> <p>4. Pasi që Këshilli ka mbyllur takimin asnjë anëtar i Këshillit apo asnjë person pjesëmarrës në takim nuk diskuton mbi natyrën, përmbajtjen apo rezultatin e takimit përpos nëse me ligj është paraparë ndryshe.</p> <p>5. Këshilli mund të thërrasë takim urgjent për të adresuar çështjet që lidhen me sigurinë e godinave ose personelit të gjykatës apo kur rrethana të veçanta kërkojnë veprim të menjëhershëm. Këshilli mund të mbledhet për seancë urgjente me thirrjen e Kryesuesit, apo nëse ky mungon, më thirrjen e Zëvendës Kryesuesit. Brenda njëzetekatër (24) orësh pas përfundimit të seancës emergjente, Kryesuesi informon publikun për natyrën e emergjencës si dhe pikat e diskutuara në takim, përveç nëse zbulimi përjashtohet me këtë nen.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Kuorumi dhe vendimmarrja</p> <p>1. Kuorumi i Këshillit formohet me nëntë (9) anëtar.</p> <p>2. Vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji parasheh ndryshe.</p>	<p>3.8. any other information whose disclosure would constitute a violation of the law.</p> <p>4. Once the Council has closed the meeting, no member of the Council or any other person attending the meeting shall discuss the nature, content or outcome of the meeting unless otherwise provided by law.</p> <p>5. An urgent meeting of the Council may be called to address issues related to the safety and security of facilities or court staff, or where exceptional circumstances require immediate action. The Council may convene an urgent session upon the call of the Chair or Vice-Chair in the absence of the Chair. The Chair shall, within twenty-four (24) hours from the end of an emergency session, disclose to the public the nature of the emergency and the issues discussed at the meeting, unless such disclosure is exempted as provided under this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Quorum and decision-taking</p> <p>1. The quorum of the Council shall be composed of nine (9) members.</p> <p>2. The decisions of the Council shall be taken by a simple majority vote of the members present, unless otherwise provided by law.</p>	<p>3.8. bilo koje druge informacije čije bi objavljivanje predstavljalo kršenje zakona.</p> <p>4. Nakon što Savet zaključi sastanak, nijedan član Saveta niti bilo koja osoba koja učestvuje na sastanku neće raspravljati o prirodi, sadržaju ili ishodu sastanka, osim ukoliko nije zakonom nije drugačije određeno.</p> <p>5. Savet može raspisati hitan sastanak radi rešavanja pitanja koja se odnose na sigurnost zgrada ili osoblja suda, ili onda kada posebne okolnosti zahtevaju hitno delovanje. Savet može sazvati hitan sastanak na zahtev predsedavajućeg, ili ako je isti odsutan, na poziv zamenika predsedavajućeg. U roku od dvadeset četiri (24) sata nakon završetka hitne sednice, predsedavajući će obavestiti javnost o prirodi vanrednog stanja, kao i tačkama o kojima se raspravlja na sastanku, osim ako je objavljivanje informacija isključeno ovim članom.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Kvorum i donošenje odluka</p> <p>1. Kvorum Saveta čini devet (9) članova.</p> <p>2. Odluke Saveta donose se prostom većinom glasova prisutnih članova, osim ako zakonom nije drugačije određeno.</p>
--	--	--

<p>3. Kryesuesi, gjegjësisht Zëvendëskryesuesi kur udhëheq mbledhjen e Këshillit, voton i fundit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Komisionet e Këshillit</p> <p>1. Këshilli ka komisionet e veta të përhershme si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Komisioni për Çështje Normative;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Komisioni për Inspektim Gjyqësor;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Komisioni për Administrimin e Gjykatave;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.5. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel;</p> <p>2. Këshilli mund të themelojë komisione tjera sipas nevojës.</p> <p>3. Komisionet, nga paragrafi 1 i këtij neni, udhëhiqen nga anëtarët gjyqtarë të Këshillit.</p> <p>4. Këshilli nxjerrë rregullore për detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve të përcaktuara në këtë nen.</p>	<p>3. The Chair, or Vice Chair, when chairing the Council meeting, shall be the last to vote.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Council Committees</p> <p>1. The Council shall have its standing committees as follows:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 Committee for Normative Issues;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 Committee for Judicial Inspection;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3 Committee for Evaluation of Judges' Performance;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Committee for Court Administration;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.5 Committee for Budget, Finance and Personnel;</p> <p>2. The Council may establish, as appropriate, other committees.</p> <p>3. The committees referred to in paragraph 1 of this Article shall be led by a judge members of the Council.</p> <p>4. The Council shall issue regulations on the duties and responsibilities of the Committees set out in this Article.</p>	<p>3. Predsedavajući ili zamenik predsedavajućeg, prilikom predsedavanja sednicom Saveta glasa poslednji.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Komisije Saveta</p> <p>1. Veće ima svoje stalne komisije:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Komisiju za normativna pitanja;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Komisiju za sudsku inspekciju i preispitivanje rada sudija;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Komisiju za procenu učinka sudija</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Komisiju za sudsku administraciju;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.5. Komisiju za budžet, finansije i osoblje;</p> <p>2. Savet može uspostaviti, prema potrebi, druge komisije.</p> <p>3. Komisije navedene unutar stava 1 ovog člana, će voditi član Saveta iz reda sudija.</p> <p>4. Savet donosi pravilnik o dužnostima i odgovornostima komisija navedenih u ovom članu.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 17 Buxheti</p> <p>1. Këshilli harton buxhetin vjetor dhe ia dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit.</p> <p>2. Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për Këshillin dhe gjykatat në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimit të fondeve dhe mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale dhe kryerjen e auditimeve financiare.</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Budget</p> <p>1. The Council shall draft the annual budget and submit such proposal for approval to the Assembly.</p> <p>2. The Council manages the annual budget for the Council and the courts independently and is responsible for overseeing expenditure, allocating funds, maintaining accurate and current accounts and carrying out financial audits.</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Budžet</p> <p>1. Savet sastavlja godišnji budžet i podnosi ga Skupštini na odobrenje.</p> <p>2. Savet samostalno upravlja godišnjim budžetom Saveta i sudova nezavisno, i odgovoran je za nadgledanje troškova, sakupljanje fondova, održavanje trenutnih računa i vršenje finansijskih revizija.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 18 Paga e Kryesuesit dhe anëtarëve të Këshillit</p> <p>1. Gjatë mandatit të tyre, Kryesuesi, dhe anëtarët me orar të plotë të Këshillit pranojnë pagën si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Kryesuesi pranon pagë ekuivalente me pagën e Kryetarit të Gjykatës Supreme;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Zëvendëskryesuesi dhe anëtarët me orar të plotë pranojnë pagën ekuivalente të gjyqtarit të Gjykatës Supreme;</p> <p>2. Anëtarët jogjyqtarë të Këshillit dhe ata me orar jo të plotë, kanë të drejtë në</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 The salary of the Chair and the Council members</p> <p>1. During their term of office, the Chair and the members of the Council appointed for full time, shall receive their salaries as follows:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. The Chair receives a salary equivalent to the salary of the President of the Supreme Court.</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. The Vice-Chair and the members receive a salary equivalent to the salary of the judge of the Supreme Court.</p> <p>2. The non-judge members of the Council and those part time members are entitled to</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Plata predsedavajućeg i članova Saveta</p> <p>1. Tokom svog mandata, predsedavajući, i članovi Saveta angažovani na puno radon vreme primaju platu kako sledi:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Predsedavajući prima platu koja je jednaka plati predsednika Vrhovnog suda.</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Zamenik Predsedavajućeg i članovi sa punim random vremenom primaju jednaku platu kao sudije Vrhovnog suda.</p> <p>2. Članovi Saveta koji ne dolaze iz reda sudija kao I članovi koji nisu angažovani na puno</p>

<p>kompensim për punën e tyre si anëtarë të Këshillit. Këshilli do të miratojë skemën e kompensimit.</p> <p>3. Gjatë mandatit të tyre Kryesuesi si dhe anëtarët me orar të plotë pranojnë vetëm pagën e parashtruar në këtë nen, përveç për rimbursime të shpenzimeve të arsyeshme dhe të nevojshme që ndërlidhet me ushtrimin e detyrave të tyre dhe nuk do të pranojë kompensim shtesë nga cilido burim tjetër për detyrat apo ndonjë punësimin tjetër.</p> <p>4. Kryesuesi dhe zëvendës-kryesuesi, me skadimin e shërbimit të tyre do të pranojnë kompensimin që lidhet me pozitën fillestare gjyqësore në të cilën këta do të kthehen.</p> <p>5. Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe anëtarët e Këshillit nuk kanë të drejtë të ushtrorjnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>6. Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe anëtarët e Këshillit mund të merren me veprimtari shkencore, kulturore, akademike dhe veprimtari tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me funksionet e tyre dhe me legjisllacionin në fuqi.</p>	<p>compensation for their work as members of the Council. The Council will adopt the compensation scheme.</p> <p>3. During their term of office, the Chair, the Vice-Chair as well as full time members shall only accept the salary set out under this Article, except for reimbursement of reasonable and necessary expenditures related to the exercise of their duties and shall not receive any additional compensation from any other source for other duties or employment.</p> <p>4. Chair and the Vice-Chair, upon expiry of their term, shall will receive the compensation of the initial position within the court where they will return.</p> <p>5. The Chair, the Vice-Chair and the members of the Council shall not be entitled to exercise any other public or professional duty for which they are rewarded with payment, except for teaching in higher education institutions.</p> <p>6.The Chair, the Vice-Chair and the members of the Council may engage in scientific, cultural, academic and other activities which do not contradict their functions and legislation in force.</p>	<p>radon vreme, dobijaju nadoknadu za svoj rad. Savet će usvojiti šemu naknada.</p> <p>3. Tokom mandata, predsedavajući, I članovi angažovani na puno radon vreme primaju samo platu predviđenu ovim članom, izuzev naknade razumnih troškova i onih potrebnih u vezi sa vršenjem svojih dužnosti i neće primati naknade koje proizilaze iz bilo kog drugog izvora dužnosti ili zaposlenja.</p> <p>4. Predsedavajući i Zamenik predsedavajućeg, po isteku mandata će dobiti nadoknadu koja je povezana sa početnom pozicijom unutar suda na koju će se vratiti.</p> <p>5. Predsedavajući, zamenik predsedavajućeg i članovi Saveta nemaju pravo da vrše bilo kakvu drugu javnu ili profesionalnu dužnost za koju su plaćeni, osim nastave na visokoškolskim ustanovama.</p> <p>6. Predsedavajući, zamenik predsedavajućeg i članovi Saveta mogu da se bave naučnim, kulturnim, akademskim i drugim aktivnostima koje nisu u suprotnosti sa njihovim funkcijama i sa važećim zakonodavstvom na snazi.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 19 Procedurat disiplinore për anëtarët e Këshillit</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Disciplinary procedures for Council members</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Disciplinske procedure za članove Saveta</p>
<p>1. Këshilli përcakton rregullat për zbatimin e procedurës disiplinore ndaj anëtarëve të vet duke përfshirë procedurat që rregullojnë hetimin, pezullimin ose rekomandimin për shkarkim të cilit do anëtar të Këshillit.</p> <p>2. Komision i përbërë nga tre (3) anëtarë, njëri nga të cilët duhet të jetë anëtar gjyqtarë i Këshillit, dhe dy të tjerë nga radhët e gjyqtarëve, i themeluar nga Këshilli, vendos për masat disiplinore dhe për sanksione, përfshirë pezullimin dhe shkarkimin e cilitdo anëtar të Këshillit.</p> <p>3. Me rekomandimin e Komisionit, një anëtar i Këshillit mund të shkarkohet me anë të dy të tretave (2/3) të votave të anëtarëve të Këshillit.</p> <p>4. Një (1) anëtar i Këshillit i cili është shkarkuar gëzon të drejtën të ankohet kundër vendimit të Këshillit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit për shkarkim.</p>	<p>1. The Council shall determine the rules for the implementation of disciplinary procedures for its members, including the procedures governing the investigation, suspension or recommendation for dismissal of any Council member.</p> <p>2. A committee established by the Council composed of three (3) members, one of whom shall be a judge of the Council, and two other judges, shall decide on disciplinary measures and sanctions, including suspension and dismissal of any member of the Council.</p> <p>3. On the recommendation of the Committee, a member of the Council may be dismissed by two-thirds (2/3) of the votes of the members of the Council.</p> <p>4. One (1) member of the Council who has been dismissed, has the right to appeal against the Council's decision directly to the Supreme Court within fifteen (15) days from the decision for dismissal.</p>	<p>1. Savet određuje pravila za sprovođenje disciplinskog postupka protiv svojih članova, uključujući procedure koje se odnose na istragu, suspenziju ili preporuku za razrešenje člana Saveta.</p> <p>2. Komisija, sastavljena od tri (3) člana, od kojih je jedan sudija Saveta, a dvojica ostalih sudije, koje uspostavlja Savet, odlučuju o disciplinskim merama i sankcijama, uključujući suspenziju i razrešenje bilo kojeg člana Saveta.</p> <p>3. Po preporuci Komisije, član Saveta može biti razrešen na osnovu dve trećine (2/3) glasova članova Saveta.</p> <p>4. Jedan (1) član Saveta koji je razrešen, ima pravo žalbe protiv odluke Saveta direktno Vrhovnom sudu u roku od petnaest (15) dana od dana prijema odluke o razrešenju.</p>

<p>KREU III - REKRUTIMI, EMËRIMI DHE SHKARKIMI I GJYQTARËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Rekrutimi i Gjyqtarëve</p> <p>1. Këshilli, përmes një njoftimi publik fton të gjithë profesionistët e kualifikuar ligjorë që të aplikojnë për kandidatë për emërimë gjyqësore.</p> <p>2. Me rastin e rekrutimit të një kandidati, Këshilli, në mes tjerash do të marrë parasysh kriteret në vijim:</p> <p>2.1. njohuritë profesionale, përvojën e punës dhe performancën, përfshirë të njohuritë dhe respektimin e të drejtave të njeriut;</p> <p>2.2. kapacitetin për arsytetime ligjore të dëshmuar përmes veprimtarive profesionale në fushën e drejtësisë, përfshirë këtu përvojën si gjyqtar, prokuror apo avokat, punë akademike apo veprimtari tjetër profesionale;</p> <p>2.3. aftësinë profesionale bazuar në rezultat a karrierës së mëparshme, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performansa;</p>	<p>CHAPTER III - RECRUITMENT, APPOINTMENT AND DISMISSAL OF JUDGES</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Recruitment of judges</p> <p>1. The Council, through a public announcement, invites all qualified legal professionals to apply as candidates for judicial appointments.</p> <p>2. When recruiting a candidate, the Council shall, inter alia, consider the following requirements:</p> <p>2.1. professional knowledge, work experience and performance, including knowledge and respect for human rights;</p> <p>2.2. capacity for legal justifications as evidenced by professional activities in the field of justice, including in the capacity of a judge, prosecutor or lawyer, academic or other professional activity;</p> <p>2.3. the professional ability based on the result of the previous career, including participation in organized training forms where performance is assessed;</p>	<p>POGLAVLJE III - REGRUTIRANJE, IMENOVANJE I RAZREŠENJE SUDIJA</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Regrutovanje sudija i sudija porotnika</p> <p>1. Savet, putem javnog oglasa, poziva sve kvalifikovane pravne stručnjake da podnesu prijavu na konkurs za sudske pozicije.</p> <p>2. Tokom regrutovanja kandidata, Savet će između ostalog razmotriti i sledeće kriterijume:</p> <p>2.1 stručno znanje, radno iskustvo i učinak, uključujući poznavanje i poštovanje ljudskih prava;</p> <p>2.2 sposobnost pravnog obrazloženja, dokazano profesionalnim aktivnostima u oblasti pravosuđa, uključujući tu i iskustvo u svojstvu sudije, tužioca ili advokate, akademsku ili drugu profesionalnu aktivnost;</p> <p>2.3 profesionalnu sposobnost zasnovanu na rezultatima prethodne karijere, uključujući učešće u organizovanim obrascima obuke putem kojih se procenjuje učinak;</p>
---	--	---

<p>2.4. aftësinë dhe kapacitetin në analizimin e problemeve ligjore;</p> <p>2.5. aftësinë për të kryer detyrat e zyrës në mënyrë të paanshme, të vetëdijshme, të zellshme, të vendosur dhe të përgjegjshme;</p> <p>2.6. aftësinë komunikuese;</p> <p>2.7. sjelljen jashtë zyrës; dhe</p> <p>2.8. integritetin personal.</p> <p>3. Kryetari i gjykatës apo gjyqtari mbikqyrës, obligohet të njoftojë KGJK-në për përfundimin e rregullt të mandatit të gjyqtarit, të paktën 90 ditë më herët.</p> <p>4. Këshilli zhvillon procedurat për rekrutimin e kandidatëve për t'u emëruar si gjyqtarë të cilat janë në përputhje me Kushtetutën dhe kriteret për pranim në gjyqësor të miratuara nga Këshilli me akt nënligjor.</p> <p>5. Procesi i rekrutimit të gjyqtarëve porotë do të përcaktohet me rregullore të Këshillit dhe kryhet nga gjykatat përkatëse.</p>	<p>2.4. ability and capacity to analyze legal problems;</p> <p>2.5. the ability to perform office tasks in an impartial, conscious, diligent, decisive and accountable manner;</p> <p>2.6. communication skills;</p> <p>2.7. behaviour outside the office; and</p> <p>2.8. personal integrity.</p> <p>3. The President of the Court or the Supervising Judge shall be obligated to notify the KJC, at least 90 days in advance, on the regular completion of the judge's term.</p> <p>4. The Council develops and implements procedures for recruiting candidates to be appointed as judges that are in accordance with the Constitution and the requirements for admission to the judiciary approved by the Council by a sub-legal act.</p> <p>5. The recruitment process of lay judges shall be defined by a regulation adopted by the Council and it will be carried out by respective courts.</p>	<p>2.4. sposobnost I kapacitet u analiziranju pravnih problema;</p> <p>2.5. sposobnost da obavlja posao nepristrasno, svesno, marljivo, odlučno i odgovorno;</p> <p>2.6. komunikacione sposobnosti;</p> <p>2.7. ponašanje van kancelarije;</p> <p>2.8. lični integritet.</p> <p>3. Predsednik suda ili nadzorni sudija će biti obavezani obavestiti Sudski savet Kosova, najmanje 90 dana unapred, vezano za približavanje isteka mandata sudije.</p> <p>4. Savet razvija I implementira procedure vezane za regrutovanje kandidata za sudske pozicije, koje su u skladu sa Ustavom, kao I kriterijume za prihvatanje unutar pravosudnog sistema, kako je predviđeno pravilnikom Saveta.</p> <p>5. Procedura regrutovanja sudije porotnika će biti definisana pravilnikom donesenom od strane Saveta, koju će primenjivati sudovi.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 21 Njësia për verifikim gjyqësor</p> <p>1. Procedura për verifikimin e të kaluarës të kandidatit duhet të bëhet me kujdes maksimal dhe në mënyrë strikte në pajtim me parimet e sundimit të ligjit. Këshilli mund të kërkojë një kontroll standard për dosje penale dhe baza të tjera që mund ta diskualifikojnë kandidatin nga policia.</p> <p>2. Vendimi për të refuzuar një kandidat të bazuar në kontrollet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të arsyetohet. Rezultatet e këtij kontrolli duhet të jenë në dispozicion të kandidatit, i cili ka të drejtën të paraqesë ankesë në gjykatë ndaj vendimit për refuzim të tij/saj.</p> <p>3. Ndalohet kryerja e kontrolleve të tjera nga çdo shërbim sigurie përpos kontrollit të kërkuar nga Këshilli sipas paragrafit 1 të këtij neni.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 21 Unit for judicial verification</p> <p>1. The procedure for verifying candidate's background must be done with utmost care and strictly in accordance with the principles of the rule of law. Council may require a standard criminal records check and other grounds that may disqualify the candidate from the police.</p> <p>2. The decision to refuse a candidate based on the controls provided for in paragraph 1 of this Article should be justified. The results of this control should be available to the candidate, who has the right to file a complaint to the court against the decision on his/her refusal.</p> <p>3. It is forbidden to carry out other controls by any security service other than the control required by the Council under paragraph 1 of this Article.</p>	<p style="text-align: center;">Član 21 Jedinica za sudsku proveru</p> <p>1. Procedura za proveru prošlosti kandidata treba biti obavljena prema najvećem stepenu pažnje i striktno, na osnovu načela vladavine prava. Savet može tražiti standardnu kontrolu koja obuhvata kriminalni dosije kao i druge osnove koje mogu diskvalifikovati kandidata, zbog informacija sakupljenih od strane policije.</p> <p>2. Odluka o diskvalifikaciji kandidata, osnovanoj na kontroli predviđenoj par.1 ovog člana, treba biti obrazložena. Uvid u rezultat ove kontrole treba biti omogućen kandidatu, koji ima pravo uložiti žalbu na sudu, protiv njene/nejgovog odbijanja.</p> <p>3. Zabranjeno je obavljanje druge kontrole, koju može obaviti bilo koja druga služba sigurnosti, osim one koju Savet može tražiti, prema par.1 ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 22 Propozimi për emërim</p> <p>1. Këshilli, pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit i dërgon Presidentit propozimet e kandidatëve për t'u emëruar gjyqtarë me mandat fillestar trevjeçar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 22 Proposal for appointment</p> <p>1. The Council shall, after conducting recruitment procedures, submit to the President proposals for candidates to be appointed judges and lay judges with a three-year initial term.</p>	<p style="text-align: center;">Član 22 Predlog za imenovanje</p> <p>1. Savet će, nakon obavljanje procedure regrutovanja, uputiti Predsedniku predlog kandidate za imenovanja na poziciju sudije i sudija porotnika sa trogodišnjim početnim mandatom.</p>

<p>2. Propozimi duhet të përfshijë një raport me shkrim për procesin dhe për kandidatin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Emërimi i Gjyqtarëve</p> <p>1. Presidenti emëron gjyqtarët në sistemin gjyqësor me mandat fillestar trevjeçar bazuar në propozimet e Këshillit.</p> <p>2. Presidenti, brenda 60 ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për emërimin në detyrën e gjyqtarit të kandidatit të propozuar nga Këshilli. Nëse brenda këtij afati Presidenti nuk e emëron gjyqtarin, Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj Presidenti emëron gjyqtarin sipas propozimit të Këshillit.</p>	<p>2. The proposal should include a written report on the process and the candidate.</p> <p style="text-align: center;">Article 23 Appointment of judges</p> <p>1. The President appoints judges in the judicial system with a three-year initial mandate based on the Council’s proposals.</p> <p>2. Within 60 days after the receipt of the proposal, the President shall issue a decree on the appointment as judge of the candidate proposed by the Council. If within this deadline the President does not appoint the judge, the Council may re-submit the proposed candidate together with the supplementary reasoning in writing. Thereafter the President appoints the judge upon the proposal of the Council.</p>	<p>2. Predlog treba da sadrži I pisani izveštaj o procesu i kandidatu.</p> <p style="text-align: center;">Član 23 Imenovanje sudija</p> <p>1. Predsednik imenuje sudije u pravosudnom sistemu sa trogodišnjim početnim mandatom na osnovu predloga Saveta.</p> <p>2. U roku od 60 dana od prijema predloga, Predsednik izdaje dekret o imenovanju sudija, kandidata predloženih od strane Saveta. Ukoliko u tom roku Predsednik ne imenuje sudiju, Savet može ponovo predložiti istog kandidata, priložeći dodatno obrazloženje u pismenoj formi. Nakon toga Predsednik imenuje sudiju na predlog Saveta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 24 Betimi i gjyqtarëve</p> <p>1. Gjyqtari i sapoemëruar me mandat fillestar trevjeçar, merr detyrën pasi të ketë dhënë betimin para Presidentit.</p> <p>2. Teksti i betimit është si në vijim:</p> <p style="text-align: center;"><i>“Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Republikës së Kosovës, Kushtetutës, ligjeve në fuqi dhe do të</i></p>	<p style="text-align: center;">Article 24 Oath of judges</p> <p>1. A newly appointed judge with a three-year initial term of office takes office after taking oath before the President.</p> <p>2. The oath is as follows:</p> <p style="text-align: center;"><i>“I solemnly swear that during the performance of the duty I shall always remain loyal to the Republic of Kosovo, the Constitution, the laws in force and will</i></p>	<p style="text-align: center;">Član 24 Zakletva sudija</p> <p>1. Novoimenovani sudija sa trogodišnjim mandatom započinje mandat nakon što položi zakletvu pred Predsednikom.</p> <p>2. Tekst zakletve je sledeći:</p> <p style="text-align: center;"><i>Švečano se zaklinjem da ću tokom obavljanja dužnosti uvek ostati lojalan Republici Kosovo, Ustavu, važećim zakonima i poštovati pravila profesionalne</i></p>

<p><i>respektoj rregullat e etikës profesionale si dhe do t'i kryej me besnikëri në mënyrë të pavarur profesional dhe të paanshme detyrat dhe funksionet që më janë besuar”.</i></p> <p>3. Betimi i gjyqtarëve të sapoemëruar me mandat fillestar trevjeçar bëhet me një ceremoni publike para Presidentit, nëse Presidenti nuk vendos ndryshe.</p> <p>4. Zyra e Presidentit, miraton Rregullore për ceremoninë e betimit të gjyqtarëve.</p>	<p><i>respect the rules of professional ethics and will perform faithfully, independently, professionally and impartially the duties and functions entrusted to me”.</i></p> <p>3. The oath of newly appointed judges with a three-year initial mandate is made in a public ceremony before the President, unless the President decides otherwise.</p> <p>4. The Office of the President approves the Regulation on the oath ceremony of judges.</p>	<p><i>etike i vršiti ću pouzdano, nezavisno, profesionalno i nepristrasno dužnosti i funkcije koje su mi poverene ”.</i></p> <p>3. Zakleta novoimenovanih sudija sa trogodišnjim mandatom vrši na javnoj svečanoj ceremonijom pred Predsednikom, osim ako Predsednik ne odluči drugačije.</p> <p>4. Kancelarija Predsednika donosi pravilnik o ceremoniji davanja zakletve sudija.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 25 Riemërimi i Gjyqtarëve</p> <p>1. Presidenti riemëron gjyqtarët në sistemin gjyqësor me mandat të përhershëm bazuar në propozimet e Këshillit.</p> <p>2. Presidenti, brenda 30 ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për emërimin në detyrën e gjyqtarit të kandidatit të propozuar nga Këshilli me mandat të përhershëm. Nëse brenda këtij afati Presidenti nuk e emëron gjyqtarin, Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj Presidenti emëron gjyqtarin sipas propozimit të Këshillit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 Reappointment of judges</p> <p>1. The President reappoints judges in the judicial system with a permanent mandate based on the Council’s proposals.</p> <p>2. Within 30 days after the receipt of the proposal, the President shall issue a decree on the appointment as a judge of the proposed candidate by the Council for a permanent mandate. If within this period the President does not appoint the judge, the Council may re-submit the proposed candidate together with the supplementary reasoning in writing. Thereafter the President appoints the judge upon the proposal of the Council.</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Ponovno imenovanje sudija</p> <p>1. Predsednik ponovo imenuje sudije u pravosudnom sistemu na stalni mandat, na osnovu predloga Saveta.</p> <p>2. U roku od 30 dana od prijema predloga, Predsednik izdaje dekret o imenovanju sudije na stalni mandat, na predlog Saveta. Ukoliko u tom roku Predsednik ne imenuje sudiju, Savet može predložiti ponovo istog kandidata priložeci dodatno obrazloženje u pismenoj formi. Nakon toga Predsednik imenuje sudiju na predlog Saveta.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 26 Shkarkimi i gjyqtarëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Dismissal of judges</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Razrešenje sudija</p>
<p>1. Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.</p> <p>2. Gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.</p> <p>3. Këshilli, para dërgimit të propozimit për shkarkim të gjyqtarit, siguron që të jenë përfunduar të gjitha procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>4. Këshilli, pas sigurimit se kanë përfunduar të gjitha procedurat përkatëse i dërgon Presidentit propozimet për shkarkimin e gjyqtarit.</p> <p>5. Propozimi duhet të përfshijë një raport me shkrim dhe propozimin e Këshillit për shkarkimin e gjyqtarit.</p> <p>6. Presidenti, brenda 30 ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për shkarkimin e gjyqtarit të propozuar nga Këshilli. Nëse brenda këtij afati Presidenti nuk e shkarkon gjyqtarin, Këshilli paraqet edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj Presidenti shkarkon gjyqtarin</p>	<p>1. Judges may be dismissed from office because of the punishment for a criminal offense or for serious neglect of duties.</p> <p>2. Judges have the right to appeal the decision on dismissal directly to the Supreme Court of Kosovo.</p> <p>3. Before submitting a proposal for dismissal of a judge, the Council shall ensure that all relevant procedures under the legislation in force are completed.</p> <p>4. The Council, after ensuring that all relevant procedures have been completed, shall submit to the President the proposals for dismissal of the judge.</p> <p>5. The proposal should include a written report on the process and the candidate.</p> <p>6. The President, within 30 days after the receipt of the proposal, issues a decree on the dismissal of the judge proposed by the Council. If within this period the President does not dismiss the judge, the Council re-submits the proposed candidate together with the supplementary reasoning in writing. Thereafter, the President dismisses the judge</p>	<p>1. Sudije mogu biti razrešene sa dužnosti zbog kazne za krivično delo ili zbog ozbiljnog kršenja dužnosti.</p> <p>2. Sudije imaju pravo žalbe na odluku o razrešenju direktno Vrhovnom sudu Kosova.</p> <p>3. Pre podnošenja predloga za razrešenje sudija, Savet će se osigurati da je sprovedena procedura predviđena zakonodavstvom na snazi.</p> <p>4. Savet, nakon što bude siguran da je završena predviđena procedura, predaće Predsedniku predlog za razrešenje sudije.</p> <p>5. Predlog treba da sadrži pisani izveštaj o procesu i kandidatu.</p> <p>6. U roku od 30 dana od prijema predloga, Predsednik donosi dekret o razrešenju sudije na predlog Saveta. Ukoliko u tom roku Predsednik ne razreši sudiju, Savet ponovo podnosi predlog zajedno sa naknadnim obrazloženjem u pismenoj formi. Nakon toga Predsednik će razrešiti sudiju na predlog Saveta.</p>

<p>sipas propozimit të Këshillit.</p> <p>7. Para zbatimit të vendimit të tillë, gjyqtari njoftohet zyrtarisht nga Këshilli lidhur me vendimin e Presidentit për miratimin apo mosmiratimin e shkarkimit nga detyra.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Lirimi nga detyra i gjyqtarëve</p> <p>1. Në rastet e dorëheqjes dhe pensionimit të gjyqtarëve, Këshilli i dërgon propozimin Presidentit për lirim nga detyra.</p> <p>2. Presidenti brenda 30 ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për lirim nga detyra të gjyqtarit.</p>	<p>on the proposal of the Council.</p> <p>7. Prior to the implementation of such a decision, the judge shall be officially informed by the Council on the decision of the President on approving or refusing the dismissal.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 Discharge of judges</p> <p>1. In cases of resignation and retirement of judges, the Council shall send the proposal to the President for discharge from office.</p> <p>2. Within 30 days after receipt of the proposal, the President shall issue a decree on the discharge of the judge.</p>	<p>7. Pre sprovođenja takve odluke, sudiju će zvanično obavestiti Savet u vezi odluke Predsednika kojom odobrava ili odbija razrešenje sa dužnosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Razrešenje sudija sa dužnosti</p> <p>1. U slučajevima ostavke i penzionisanja sudija Savet šalje predlog Predsedniku za razrešenje sa dužnosti.</p> <p>2. U roku od 30 dana od prijema predloga, Predsednik izdaje dekret o razrešenju sudije sa dužnosti.</p>
<p>KREU IV - VLERËSIMI, AVANCIMI DHE TRANSFERIMI I GJYQTARËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve</p> <p>1. Këshilli përcakton kriteret për vlerësimin e performancës dhe avancimin e gjyqtarëve, sipas aktit nënligjor të nxjerrë nga Këshilli, i cili duhet të përfshijë së paku:</p>	<p>CHAPTER IV- ASSESSMENT, PROMOTION AND TRANSFER OF JUDGES</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Performance assessment of judges</p> <p>1. The Council shall establish requirements for the assessment of performance and promotion of judges in accordance with the sub-legal act issued by the Council, which shall include at least:</p>	<p>POGLAVLJE IV - PROCENA, PROMOVISANJE I TRANSFER SUDIJA</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Vrednovanje učinka rada sudija</p> <p>1. Savet će odrediti kriterijume za vrednovanje učinka rada i unapređenja sudija, u skladu sa podzakonskim aktom Saveta, koji mora obuhvatiti najmanje:</p>

